



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:037564

Datë: 16.02.2024

Numri i dokumentit: 05337855

P.nr. 151/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Penal, në përbërje me gjyqtarin e vetëm gjykues Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit, I.T, për shkak se ka kryer veprën penale, “Mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare” nga neni 430 paragrafi. 2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.3329/2022 e datës: 30.01.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë: 13.02.2024, ku morën pjesë, Prokurori i Shteti Besnik Jakupi, mbrojtësi i të akuzuarit Av. Asdren Hoxha, si dhe i akuzuari I.T, shpalli me të njëjtën datë 16.02.2024, dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

I.T, i lindur me “data e lindjes”, në Mitrovicë, me numër personal “letërnjoftim”, me vendbanim në fshatin “emri i fshatit” dhe në Rr. “Rruga” nr., Komuna Zveçan, i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, Nacionaliteti Serb, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri I.T në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Publik –“pozita e punës” të Republikës së Kosovës, me datë 31 Mars 2021, në formularin e dorëzuar për deklarinimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik për vitin 2020, nga 1 janar – 31 dhjetor 2021, nuk ka paraqitur të dhënat e kërkuara në deklaratë që e ka pasur obligim ta deklarojë pasurinë, të ardhurat, të dobive tjera pasurore ose detyrimeve financiare të përcaktuara me nenin 3 paragrafi 1, pika 1.1.8, të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Dhuratave, Nr. 04/L-

050, ashtu qe përkatësisht i pandehuri nuk i ka deklaruar pronat të cilat kanë qenë të evidentuara ne emër të prindit të tij V.T.

- me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, nga neni 430 paragrafi 2”, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.07/L-64 .

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 50, 69, 70 dhe 430 par. 2 të KPRK-së dhe neneve, 230, 358, 364 dhe 365 të KPPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

**DENIM ME BURGIM ME KUSHT
dhe DENIM ME GJOBË**

- I. I akuzuari: I.T, dënohet me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim, nuk do të ekzekutohet, nëse i njëjti nuk kryen vepër tjetër penale në afat prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Të akuzuarit, i shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 800 (tetëqind) Euro, të cilën gjobë është i obliguar të paguan në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.
- III. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgim duke e llogaritur, 20 (njëzet) Euro me 1 (një) ditë burgim.
- IV. Obligohet i akuzuari që t’i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20.00 (njëzet) Euro, për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 20.00 (njëzet) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A R S Y E T I M

Rrjedha e procedurës, Historiku:

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.3329/2022 e datës: 30.01.2024, kundër të akuzuarit, I.T, për shkak se ka kryer veprën penale, “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare”, nga neni 430 paragrafi 2, Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Kompetenca e gjykatës:

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrim të aktakuzës, ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore.

Sa i përket kompetencës territoriale, gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPPRK-së, kompetencë territoriale për të gjykuar një çështje juridiko-penale ka gjykata në territorin e së cilës është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale, apo gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret, vepra penale është kryer në Prishtinë, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konsideron se me qenë se për veprën penale “*Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare*”, nga neni 430 paragrafi 2, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.07/L-64, parashihet dënim me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, po ashtu meqenëse e njëjta vepra nuk është paraparë me nenin 22 të KPPRK-së, atëherë gjykata konstaton se departamenti i përgjithshëm ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Shqyrtimi gjyqësor:

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të aktakuzës, si dhe gjate analizimit të lëndës ka konstatuar se pala e akuzuar ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë në prokurori e cila është bashkangjitur në shkresat e lëndës dhe mbanë shenjen PP.II.nr. 3329/22 të datës: 26.01.2024, andaj ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë: 13.02.2024, ku gjatë kësaj seance kanë qenë prezent Prokurori i Shtetit Besnik Jakupi, mbrojtësi i të akuzuarit Av. Asdren Hoxha, si dhe i akuzuari I.T. Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar ka bere plotësimin e aktakuzës, duke theksuar se në rreshtin e fundit të aktakuzës i shtohet edhe fjalët *ashtu qe përkatësisht i pandehuri nuk i ka deklaruar pronat të cilat kanë qenë të evidentuara ne emër të prindit të tij V.T, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës, ka mbetur e pa ndryshuar*. I akuzuari, pasi që janë lexuar të drejtat e tij në harmoni me nenin 241 të Kodin e Procedurës Penale nga ana e gjykatës, ka theksuar se donë qe të deklarohet.

I akuzuari I.T, pohon se donë të deklarohet dhe për këtë rast ka pranuar marrëveshjen e arritur në prokurori dhe kërkon nga gjykata që e njëjta ti aprovohet.

Mbrojtësi i të pandehurit Av. Asdren Hoxha në lidhje me marrëveshjen e arritur në prokurori nga i pandehuri deklaroi se, në tërësi mbesin pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë nr. PP.II.nr 3329/22 te lidhur me datën 26.01.2024 me Prokurorinë Themelore në Prishtinë duke mbetur pranë dënimit komulativ të rekomanduar me marrëveshje, si pjesë nën pikën I ndaj dënimit prej 1,000 Euro, ashtu edhe në pikën II të marrëveshjes së dënimit me kusht në lartësi prej 3 muaj i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës prej (1) viti nuk do të kryej veprë penale, andaj kërkon nga gjykata që me aktvendim ta aprovoj marrëveshjen në fjalë sepse është e lidhur vullnetarisht dhe në përputhje me nenin 230 të KPPRK-së.

Prokuroria e Shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se në mes të pandehurit dhe prokurorit të shtetit është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë pas negociatave bazuar në autorizimin e kryeprokurorit ashtu që sipas kësaj marrëveshje i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale si në aktakuzë dhe për këtë është marrëveshja që dënimi ti propozohet gjykatës

në marrëveshje si dënim komulativ dënim me gjobë në shumë 1,000 Euro, si dhe dënim me burg 3 muaj i cili nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti nuk kryen ndonjë veprë penale brenda një (1) viti, prandaj gjykatës i propozon që marrëveshjen e arritur në Prokurori ta aprovoj pasi që e njëjta është arritur konform dispozitave të KPPRK-së.

Vlerësimi mbi pranimin e fajësisë:

Andaj gjykata pas shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë PP.II.nr 3329/22 te lidhur me datën 26.01.2024, si dhe deklarimet për pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari në pajtim me dispozitat e nenit 230 par.17 të KPPRK-së, gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se e akuzuara ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet me aktakuzë dhe atë duke u bazuar në pranimin e fajësisë nga vetë e akuzuara dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe si dhe në provat tjera të cilat i përmban aktakuzat të cilat prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar se e akuzuara ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, prandaj gjykata ka konstatuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe bazuar në nenin 230 të KPPRK-së, të njëjtën e ka pranuar dhe ka vendosur në shkresat e lëndës

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprës penale:

Se i pandehuri I.T në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Publik –“pozita e punës” të Republikës së Kosovës, me datë 31 Mars 2021, në formularin e dorëzuar për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik për vitin 2020, nga 1 janar – 31 dhjetor 2021, nuk ka paraqitur të dhënat e kërkuara në deklaratë që e ka pasur obligim ta deklarojë pasurinë, të ardhurat, të dobive tjera pasurore ose detyrimeve financiare të përcaktuara me nenin 3 paragrafi 1, pika 1.1.8, të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Dhuratave, Nr. 04/L-050, ashtu që përkatësisht i pandehuri nuk i ka deklaruar pronat të cilat kanë qenë të evidentuara në emër të prindit të tij V.T. Gjykata nga deklarimi i të akuzuarit në shqyrtimin fillestar dhe nga marrëveshja për pranimin e fajësisë nga ana e tij, si dhe deklarimi i prokurorit duke e pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, si dhe nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka konstatuar se janë përmbushur elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Shqiptimi i sanksionit penale:

Gjykata me rastin e matjes së dënimit mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjeti se i njëjti ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë në Prokurori e cila gjendet në shkresat e lëndës e cila mban shenjë PP.II.nr 3329/22 te lidhur me datën 26.01.2024, i cili ka qëndruar pranë marrëveshjes edhe në seancën e shqyrtimit fillestar kështu duke pranuar fajësinë lidhur me veprën penale e cila i ngarkohet sipas aktakuzës së lartcekur, ndërsa, gjykata të gjitha këto i merr si rrethana lehtësuese, andaj të akuzuarit i shqiptohet dënimi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, pasi që, i akuzuari e kishte sulmuar fizikisht të dëmtuarën, me këtë rast tek e dëmtuara kishte shkaktuar ndjenjën e ankthit, frikës dhe të pasigurisë, ashtu siç është përshkruar në aktakuzën e cila i vihet në barrë. Të akuzuarit i shqiptohet dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprës penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës në kontest të rregullt juridiko-civil:

Vendimin lidhur me udhëzimin në palës së dëmtuar në kontest juridiko civil është mbështetur në nenin 462 par 2 të KPRK-së. ku nga paragrafi 2. Citohet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”*, andaj gjykata mbi bazën e kësaj e ka udhëzuar palën në kontest të rregullt juridiko-civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale:

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1, dhe par.2 të KPRK-së. ku nga paragrafi 1. Citohet se: *Kur gjykata e shpall të akuzuarin fajtor, me aktgjykim vendos se detyrohet t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale.* Po ashtu, konform Ligjit 08/L0-109 nenit 36 par. 3. për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të akuzuarin të paguaj shumën prej 20 euro në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Baza ligjore mbi të cilën u vendos sipas këtij aktgjykimi:

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70 dhe 430. par.2 të KPRK-së dhe neneve 230, 358, 364, 365, 452, 462, të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.151/24, datë: 15.02.2024

Bashkëpunëtori profesional:
Asdren Selmani

Gjyqtari:
Sabit Sadikaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykatë, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.